



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Bashkëfinancuar nga  
Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim



Sweden  
Sverige

## Koalicioni i Ballkanit Perëndimor publikon Raportin Rajonal mbi Diskriminimin me Bazë Gjinore dhe Punësimin

Sot, më 30 maj, Koalicioni i Organizatave për të Drejtat e Grave kundër Diskriminimit në Ballkanin Perëndimor (BP), pjesë e së cilit është edhe Rjeti i Grave të Kosovës (RrGK) lansoi përmes platformës Zoom botimin e dytë të raportit hulumtues [Diskriminimi me Bazë Gjinore dhe Punësimi në Ballkanin Perëndimor](#).

Hulumtimi synon të identifikojë mangësitë në kuadrin ligjor përkatës; ndërgjegjësimin dhe përhapjen e diskriminimit me bazë gjinore në lidhje me punësimin; shkallën në të cilën njerëzit kanë paraqitur ankesa; dhe se si i kanë trajtuar institucionet rastet e tilla. Hulumtimi u krye nga organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave (OSHC) në kuadër të nismës rajonale "Fuqizimi i OSHC-ve në Luftimin e Diskriminimit dhe Përmirësimi i të Drejtave të Grave në Punë" në Kosovë, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, dhe Serbi. Nisma është mbështetur nga Bashkimi Evropian (BE) dhe është bashkëfinancuar nga Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim. **Gjetjet** kryesore përfshijnë:

- Asnjë qeveri nuk e ka harmonizuar plotësisht kuadrin ligjor në përputhje me Direktivën e BE-së për Balancin Punë-Jetë. Ekzistojnë çështje të ndryshme në lidhje me të drejtat e pushimit, veçanërisht leja prindërore, e atësisë dhe e kujdestarëve;
- Edhe pse ndërgjegjësimi se diskriminimi me bazë gjinore është i paligjshëm duket se është përmirësuar pak, shumë njerëz ende nuk dinë se ku dhe si ta raportojnë atë;
- Diskriminimi me bazë gjinore lidhur me punësimin ka mbetur i përhapur në Ballkanin Perëndimor (BP), duke përfshirë punësimin, ngritjen në detyrë, pagën, kontratat, të drejtat e shtatzënisë dhe lejen e lehonisë, të atësisë dhe ngacmimet seksuale në punë.
- Personat LGBTQI+, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë nga grupet e pakicave etnike raportuan se u përballën me diskriminim të shumëfishtë, ndërsektorial.
- Pak njerëz raportuan diskriminim me bazë gjinore për shkak të vetëdijes së ulët se si ta raportojnë atë; mungesës së besimit në institucione; shqetësimit nga stigmatizimi; frikës nga humbja e punës ose forma tjera viktimizimi; si dhe për shkak të drejtësisë së vonuar e shpesh të shtrenjtë ose procedurave të tjera.

Sipas raportit, institucionet e BP-së nuk ruajnë të dhëna adekuate të ndara sipas gjinisë për rastet e raportuara të diskriminimit me bazë gjinore lidhur me punësimin. Po ashtu, njohuritë e inspektorëve të punës në lidhje me diskriminimin me bazë gjinore mbesin të ulëta në të gjithë rajonin.

Meqenëse pak raste janë raportuar në institucionet përkatëse, edhe më tej pak institucione kanë përvojë në trajtimin e rasteve të diskriminimit me bazë gjinore. Megjithatë, Nisma e Koalicionit të lartpërmendur ka shtuar numrin e rasteve të trajtuara nga institucionet dhe ka sjellë drejtësi për disa gra të cilave u janë shkelur të drejtat.

Ndërkohë, monitorimi rajonal sugjeron se ende ka vonesa nga gjykatat në trajtimin e çështjeve, dhe gjendja është rënduar gjatë pandemisë COVID-19.

Zbatuar nga:



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Alianca Gjinore për Zhvillim



KVINNA  
KVINNA

REAC-HOR  
research in action



WOMEN'S RIGHTS CENTER  
CENTAR ZA ŽENSKA PRAVA



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Bashkëfinancuar nga  
Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim



Sweden  
Sverige

Institucioni i Avokatit të Popullit në këto shtete, si dhe Komisionerët për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në shtetet ku ata ekzistojnë) priren të kenë njohuri për këto çështje dhe puna e tyre për të trajtuar diskriminimin me bazë gjinore është përmirësuar. Rekomandimet kryesore përfshijnë:

### **Për BE-në**

- Të kërkohet zbatimi i reformave institucionale për të adresuar diskriminimin me bazë gjinore në punësim si kusht i procesit të anëtarësimit në BE.
- Të monitorohen reformat duke përdorur një qasje të standardizuar në të gjitha vendet, përmes raporteve të shteteve përkatëse.
- Të inkurajohen dhe mbështeten të gjitha vendet në harmonizimin e kuadrit ligjor me Direktivën e BE-së për Balancin Punë-Jetë.
- Të vazhdohet konsultimi dhe mbështetja e OSHC-ve, veçanërisht në reformat ligjore, ndërgjegjësimin, ofrimin e ndihmës juridike dhe rrjedhimisht monitorimin e performancës institucionale.

### **Për institucionet përgjegjëse:**

- Të harmonizohet legjislacioni kombëtar me Direktivën e BE-së për Balancin Punë- Jetë, mes ndryshimeve të tjera të nevojshme të përshkruara në raport.
- Të përmirësohet mbledhja e të dhënave, duke siguruar që të gjitha të dhënat të ndahen sipas gjinisë së viktimës/ave, autorit/ëve të supozuar, vendndodhjes dhe formës së diskriminimit. Të publikohen rregullisht të dhënat.
- Të sigurohet trajnimi i detyrueshëm dhe i institucionalizuar për zyrtarët përgjegjës për barazinë gjinore dhe transformimin e normave gjinore; për kuadrin ligjor për diskriminimin me bazë gjinore në punë dhe referime; dhe format e diskriminimit me bazë gjinore, veçanërisht ngacmimin seksual.
- Të ketë më shumë inspektorë të punës dhe zyrtarë të drejtësisë.
- Të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe OSHC-ve për të drejtat e grave, duke përfshirë ndërgjegjësimin e përbashkët për mënyrën e raportimit të diskriminimit dhe përmirësimin e besimit të publikut tek institucionet.

Në fjalën e saj hyrëse, Olga Martin Gonzalez Koordinatore e politikave për Barazi Gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata të Zgjerimit në Komisionin Evropian tha: "Puna e vazhdueshme e organizatave të shoqërisë civile për të drejtat e grave që qëndrojnë pas këtij hulumtimi rajonal kontribuon në hartimin e politikave të bazuara në fakte si dhe ofron rekomandime të dobishme për të adresuar diskriminimin me bazë gjinore në BP, nga qeveritë, shoqëria civile, bizneset dhe BE-ja".

Tanja Mišćević, Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme për Ballkanin Perëndimor në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (RCC) përgëzoi Koalicionin për raportin. Ajo tha se raporti është një "dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm" pasi do të "ndihmojë në krijimin e politikave të reja për të gjashtë ekonomitë në Ballkanin Perëndimor".

Zbatuar nga:



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



KVINNA  
KVINNA

REAC-HOR  
research in action



WOMEN'S RIGHTS CENTER  
CENTAR ZA ŽENSKA PRAVA



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

Bashkëfinancuar nga  
Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim



Sweden  
Sverige

Bruna Menalla, që përfaqësoi në cilësinë e këshilltares Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri, tha se Koalicioni ka ndihmuar këtë institucion të adresojë rastet e diskriminimit ndaj grave. Ajo vuri në pah se rrjeti ka rritur ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave.

Silvija Kostovska, Këshilltare ligjore në Shoqatën e punëtorëve të tekstilit në Maqedoninë e Veriut po ashtu ndau përvojën në mbështetjen e grave që u përballën me diskriminim dhe shkeljen e të drejtave të punësimit.

Folësit tjerë në panel ishin: David JJ Ryan, Bashkëautor; Vaska Leshoska, Hulumtuese në Reaktor-Hulumtimi në Veprim dhe Endrita Banjska, bashkëautore, RrGK. Partnerët e koalicionit kontribuan në diskutim në lidhje me gjendjen në vendet e tyre, përfshirë Mirela Arqimandriti, Drejtore Ekzekutive e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim; Svjetlana Ramić Marković, Koordinatore e Projektit e Asamblesë Qytetare të Helsinkit – Banja Luka; Adelina Terhani, Koordinatore e Projektit, RrGK; Maja Raiçević, Drejtoreshë Ekzekutive, Qendra për të Drejtat e Grave; dhe Sofija Vrbaski, Koordinatore e Projektit, Fondacioni Kvinna till Kvinna.

### Sfondi:

Raporti është përpiluar dhe shkruar nga [Rrjeti i Grave të Kosovës](#) (RrGK), [Reactor – Research in Action](#) në Maqedoninë e Veriut, [Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim](#) në Shqipëri, [Asambleja Qytetare e Helsinkit](#) Banja Luka në Bosnje dhe Hercegovinë, [Qendra për të Drejtat e Grave](#) në Mal të Zi dhe [Fondacioni Kvinna till Kvinna](#) përmes zyrës në Serbi.

Raporti i plotë është publikuar në internet, siç janë publikuar edhe raportet përkatëse për [Shqipërinë](#), [Bosnie dhe Hercegovinën](#), [Malin e Zi](#), [Maqedoninë e Veriut](#), [Kosovën](#) dhe [Serbinë](#). Ju lutemi gjeni të bashkëngjitur edhe broshurat me faktet nga raporti dhe nisma. Për informacione shtesë, ju lutemi kontaktoni: Nicole Farnsworth, Drejtore e Programit dhe Udhëheqëse e Hulumtimit në RrGK: [Nicole@womensnetwork.org](mailto:Nicole@womensnetwork.org).

Zbatuar nga:



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



KVINNA  
KVINNA

REACTOR  
research in action



WOMEN'S RIGHTS CENTER  
CENTAR ZA ŽENSKA PRAVA